Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Drejtësisë

Departamenti i Civiles

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Edukim dhe Sensibilizim

"Pesë arsye pse trendi i të quajturit veten feminist/e po nxit një të ardhme pa vajza dhe gra."

Punoi: Elisa Toçi

Master Shkencor Civil, Viti i Dytë

Tiranë, 2021

Ky punim kërkimor i dedikohet të gjitha vajzave dhe grave...

Mirëmëngjes nëna ime...

Ditët po ecin vrullshëm nën' dhe çuditërisht edhe këtë mëngjes e gjeta veten të ndjej ndenja të pafundme njerëzore që trishtueshëm kapin të njëjtin ritëm kortezhi. Ashtu turbullt në ndjesi e mendime, dëgjoj kujën e burrave atje poshtë. Ah sa i ngjante vargut "Nënë ç'ma bërë Dilinë"...

Vajtonin bijën e tyre nënë, të vetmen "Dili" që iu kish' mbetur. Mallkojnë, urrejnë, gjuajnë gjoksin, çjerrin fytyrën, oh ç'katrahurë!!!
Vuajtja nuk njihka gjini o nënë, as për burra e trima, por të mishërohet thellë në shpirt derisa ta zbrazësh me fuqinë e klithmës "oi". Qielli i kishte marrë dritën e shpirtit, se dielli nuk mjaftonte për të ngrohur fushat e malet. Nën gjamën e tyre të ndjeva ty nën'. Ndjeva atë copëtim të pafjalë që mund të pësojë një zemër prindi. Kushedi ç'pëson ai shpirt aq sa nuk njeh as zakon e kanun e i bën burrat të lëshojnë vajin e britmat sikur forca e zërit do të kthente "Dilinë" pas.

Mali ka nevojë edhe për lule o nën', jo vetëm për lisa. E lulja e tyre ishte tharë. As lotët nuk mjaftonin për ta riçelur. Mungesa e saj u dhemb…
Edhe muret ndryshuan ngjyrë, nuk ishin të qeshur si më parë. Kjo buzëqeshje e humbur dhemb…

Sa e trishtë e gjitha kjo. Sa do të jetoj toka pa ajër, deti pa ujë, e nëna pa "Dilinë"? Paska vdekje e vdekje. Ti mund të qash pa zë, me zë, me fjalë, pa fjalë, heshturazi, pa e ndjerë askush çfarë fjalësh thua, se e mori njeriu o nënë, jo Zoti. Cila të dhemb më shumë në fakt, se pavarsisht të gjithave, vdekja është po vdekje?

Fqinja tashmë e plakur shikon rrugicën e shurdhët. Zbrazëtirë të një zemre të shuar. Nuk dinte ta quante mallkim apo bekim për lulen që kish' pasur, se lisat qenkërkan të rëndë o nënë. Në të zënçin poshtë, quaje punë të mbaruar.

Por ti mos u frikëso. Jo të gjithë lulet do të kenë të njëjtin fat…

Bija jote…

Elisa Toçi

Abstrakt

Të drejtat e njeriut janë një çështje shumë e përfolur të cilat marrin rëndësi çdo ditë dhe më tepër. Ato përshkruajnë një koncept sipas të cilit të gjithë njerëzve iu takojnë që nga lindja të drejtat universale njerëzore. Është parë e rëndësishme që njerëzve t'u sigurohet e drejta për jetën dhe për të qenë i lirë në të gjithë periudhat historike.

Një numër i konsiderueshëm konventash janë shprehur përkatësisht për lirinë, duke përfshirë kuptimin e saj në një tërësi gjithëpërfshirëse, sikundër ka bërë dhe kushtetuta. Nëse do të merrej në konsideratë se cila kategori e njerëzve është në luftë të vazhdueshme për të drejtat, padiskutim që në vendin e parë janë renditur femrat. Secila kërkon diçka ndryshe, duke krijuar impaktin se pabarazia fillon që brenda llojit të tyre.

Feminizmi është një lëvizje e hershme, e lindur nga vetë nevoja e femrës për të kërkuar apo mbrojtur lirinë e saj të munguar apo cënuar. Qëllimi i këtij punim kërkimor do të përqëndrohet pikërisht tek ky problem historik i lidhur me nevojën për pavarsi të femrës, roli i saj në shoqëri, ndikimi i lëvizjeve feministe, pa neglizhuar dhe keqkuptimet që ndër vite kanë buruar nga termi i feminizmit dhe më e rëndësishmja ka të bëjë me faktin se sa të mbrojtura janë gratë dhe vajzat nga kjo lëvizje.

Për analizën e këtij punimi është përdorur qasja në të drejtën e krahasuar dhe pasqyrimi me anketime reale, në mënyrë që punimi mos të ketë karakter ngushtësisht teorik.

Fjalë kyçe: Të drejtat e njeriut, Patriarkalizmi, Barazia, Femër, Grua dhe vajzë, Feminizmi, Fuqia e femrës.

“Pesë arsye pse trendi i të quajturit veten feminist/e po nxit një të ardhme pa vajza dhe gra.”

Të rriturit përbën një atribut esencial në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë duke kontribuar në evolimin e fushave të ndryshme si teknologjia, shkenca, mënyra e të jetuarit dhe duke i dhënë përgjigje problemeve të pashmangshme të natyrës njerëzore. Në mijëra vite ekzistencë qenia humane ka arritur që me studimet dhe kërkimet e saj të arrijë deri në ndarjen e atomit, por nuk ka arritur të zbulojë përgjigjen e origjinës pasi kjo pyetje konsiderohet ende një mister i parezistueshëm dhe ka nxitur larmishmërinë e hipotezave që sipas antropologëve të ditëve të sotme konstatohet se ende nuk ka një ide absolute për origjinën e njeriut.[1] Dijetarë, filozofë, studiues të shkencës apo të fesë shprehen në mënyra dhe në këndvështrime të ndryshme, por në këtë rast do të marrim *a priori* se origjina e njeriut vjen prej natyrës dhe në rast se e njëjtja pyetje do t’i drejtohej paditurisë së një fëmije përgjigja është se origjina e tyre buron nga prindërit dhe si rrjedhojë do të fokusohemi tek qeliza bazë e shoqërisë, FAMILJA.[2]

Bazuar në strukturën fortësisht të mbështetur gjatë viteve 1950 familja ishte e krijuar nga kryefamiljari i cili mundohej të siguronte të ardhurat dhe bashkëshortja e cila kujdesej për fëmijët,[3] ndaj do të ishte e pasaktë që të trajtonim secilën gjini si monolite, por në analizën e institucionit të lartësuar të familjes, do të përqëndrohemi tek tre shkollat e mëdha të mendimit: idetë fetare, filozofia greke dhe e drejta zakonore të cilat kanë të përbashkët mes tyre pranimin e mbizotërimit të shoqërisë nga meshkujt si shkak i natyralitetit të patriarkalizmit. Në këtë mënyrë dhuna ndaj

[1] Theories of Human Origin. (1869). *The Anthropological Review*, *7*(24), fq. 1–22. Aksesuar Shtator 19, 2021, nga https://doi.org/10.2307/3025005.
[2] Nezha, A. (2017). Familja, qeliza bazë e shoqërisë njerëzore. *Sot.al.* Aksesuar Shtator 25, 2021, nga https://sot.com.al/opinion-editorial.
[3] SUGARMAN, S. D. (2008). What Is a “Family”? Conflicting Messages from Our Public Programs. *Family Law Quarterly*, *42*(2), fq 231–261. Aksesuar Shtator 25, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/25740655.

grave në një familje rezulton të jetë një "ves" i fituar herët, si shprehje e natyrshme e mbizotërimit mashkullor. Anembanë botës së lashtë janë krijuar forma të ndryshme të patriarkisë dhe ndër sistemet më të hershëm do të renditet ai hebre, të cilët ishin të parët që besuan në një Zot të vetëm, duke krijuar kështu një ndikim të konsiderueshëm në Evropën Perëndimore, fillimisht duke besuar se gruaja e parë është krijuar prej brinjës së Adamit dhe më studimet e mëvonshme pretendohet krijimi i menjëhershëm i tyre.[4] Duhet theksuar se si në qasjen dogmatike ashtu edhe në atë popullore mendimi mbizotërues në mijëra vite, madje ekzistent edhe në ditët e sotme është besimi fillestar se gruaja e parë është krijuar prej brinjës së burrit të parë, madje ky shpjegim biblik i inferioritetit femëror u mbështet edhe nga dijetarët grek siç ishte rasti i Aristotelit.[5] Një dëshmi e fuqisë patriarkale biblike do të vërehet edhe tek vepra e Shekspirit:

"Burri yt është zoti yt, jeta jote, rojtari yt,

Kreja jote, sovrani yt; ai që kujdeset për ty

Dhe për mbajtjen tënde; ia nënshtron trupin e tij

Punës së dhimbshme si në det dhe në tokë

Për të ruajtur natën në stuhi, ditën në të ftohtë

Ndërsa ti rri ngrohtë në shtëpi, e siguruar dhe e sigurtë..."[6]

Sa i takon të drejtës zakonore konfirmohet ndërthurja e teologjisë dhe shkencës, në të cilën kultura dikton patriarkinë dhe patriarkia nënshtron gratë dhe në kuadër të kësaj të drejte një bashkëshorte atashohet pranë bashkëshortit të saj duke vepruar si një trup i vetëm dhe duke krijuar një unitet

[4] Sheriati, A.. (2007). Krijimi i njeriut. *Njeriu dhe Islami.* Aksesuar Shtator 26, 2021, nga https://dielli.net/html/njeriuislam01.html.

[5] Horowitz, M. C. (1976). Aristotle and Woman. *Journal of the History of Biology*, *9*(2), 183–213. Aksesuar Shtator 26, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/4330651.

[6] Korda, N. (1996). Household Kates: Domesticating Commodities in The Taming of the Shrew. Shakespeare Quarterly, 47(2), 109–131. Aksesuar Shtator 26,2021, nga https://doi.org/10.2307/2871098.

juridik që do të nënkuptoj se ky person i vetëm i krijuar nga të dy bashkëshortët, ndryshe do të njihet si bashkëshorti. Kjo patriarki e përkufizuar në mënyra të ndryshme, por me të njëjtin thelb kuptimor proklamon të drejtën për të ndëshkuar bashkëshorten fizikisht ose verbalisht në rastet kur bashkëshkorti do të vlerësonte se do të ishte e nevojshme.

Historia e të drejtës në Shqipëri është ende e paplotë, kësisoj e drejta zakonore shqiptare do të përqëndrohet në përmbledhjen më të plotë të normave juridike të trashëguar nga e drejta kombëtare shqiptare e njohur masivisht me emrin Kanun. Kjo përmbledhje ligjore mbështet patriakalizmin dhe jo vetëm, pasi një tjetër mbështetje e saj ishte poligamia, masat ndëshkuese dragoniane dhe pa lënë mënjanë të drejtën e babait ndaj bijve të tyre.[7] Si rrjedhojë kjo përmbledhje ligjore nuk mbron familjen dhe anëtarët e saj, por mbron nderin e burrit dhe se familja dhe fëmija ishin pronë e tij, duke nënkuptuar dhe vijuar atë mendim apo parim të ndjekur që në hershmëri.[8]

Si pjesë e kulturës së përjetësuar nga këto ideologji ndër vite është tentuar të mbrohen pa dallim gjinie anëtarët e familjes për të përmirësuar ndjeshëm konceptimin e marrëdhënieve familjare. Nga fundi i shekullit të 18-të filloi të promovohej një paradigmë e re e bazuar në idetë liberale si e drejta e njeriut për barazi dhe liri, duke përbërë një parim bazë gjatë revolucioneve liberale në SHBA dhe Francë.[9] Kjo pikëpamja moderne liberale u ndoq nga dy shpjegime parësore të lidhura me metodologjinë shkencore dhe me transformimin e ideve politike, megjithatë dallimi nga burrat do të konsiderohej inferioritet të paktën deri në shekullin e 20-të duke përbërë një faktor të "frikshëm" dakordësinë e historianëve se deri në vitet 1970-të nuk ishte mundur ndonjë aksion

[7] Gjevoçi, Sh.. (1933). Libri i Tretë, Prindja. *Kanuni i Lek Dukagjinit.* Kreu VI, pika 59. Aksesuar Shtator 27, 2021, nga http://www.vatrarberesh.it/biblioteca/ebooks/kanuni.pdf.
[8] Po aty.
[9] Scott, J. W. (1989). French Feminists and the Rights of "Man": Olympe de Gouges's Declarations. *History Workshop*, *28*, 1–21. Aksesuar Shtator 29,2021, nga http://www.jstor.org/stable/4288921.

i efektshëm që do të sillte diskreditimin e dhunës ndaj grave.[10] Në kushtet e nevojës për barazi në ndihmë u vendosën lëvizjet feministe dhe lëvizjet për riaktivizimin e të drejtave civile në kuadër ndërkombëtar duke krijuar për herë të parë në aktet juridike disa koncepte të rëndësishme të cilat garantonin liritë shoqërore dhe integritetin fizik të vajzave dhe grave, duke kapërcyer efektin e faktorit biologjik. Pavarsisht aktivizimeve, lëvizjeve, aksioneve, politikave të ndjekura e të zhvilluara ndër vite rezultojnë ende kronika me në qendër gruan pasi në ditët e sotme ekziston një "fatkeqësi" e cila e konsideron kompleks paditurinë e kuptimit se *"Çfarë është një lëvizje feministe?"* që njëkohësisht po nxit individët të vetshpallen mbrojtës së kësaj ideologjie paçka se minimalisht ende nuk mund të definojnë kuptimin e termit feminizëm. Në ditët kur shkenca dhe individët janë vendosur në luftë me armiq vizualisht të padukshëm siç është "Covid-19" dhe kur në dukje demokracia e të shprehurit dhe të jetuarit është një e drejtë e garantuar për më shumë së gjysmën e popullsisë globale, bota ende po kolapsohet nga disa viktima të pazëshme në të cilën numërohen gjashtë gra apo vajza të vrara çdo një orë nga meshkujt e familjes apo partnerët e tyre.[11]

Në këto kushte kur pasojat bëhen të dukshme duke kontribuar esencialisht në frikën e të jetuarit,[12] do të shtrohet një analizë e gjerë se kush janë motivet që dërgojnë në shifra të tilla dhe çfarë aksioni po ndërmerret për të kthyer situatën në një projeksion ndryshe nga ky rezultues, ndaj në fokus të këtij punimi kërkimor është vendosur "trendi" i të quajturit veten feminist. Lëvizjet feministe janë krijuar për të mbrojtur të drejtat e cënuara të vajzave dhe grave, por duket sikur ky

[10] Skjelsbœk, I. (1997). [Review of *Women Reshaping Human Rights - -How Extraordinary Activists Are Changing the World*, by M. G. Bouvard]. *Journal of Peace Research*, *34*(1), 108–108. Aksesuar Shtator 29, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/424837.
[11] Broom, D. (2020). As the UK publishes its first census of women killed by men, here's a global look at the problem. *World Economic Forum.* Aksesuar Tetor 6, 2021, nga https://www.weforum.org/agenda/2020/11/violence-against-women-femicide-census/.
[12] Po aty.

motiv nuk mjafton për të ruajtur fortësisht ekzistencën e figurës femërore pasi me kalimin e viteve ka ndryshuar dhe mënyra se si po konceptohet feminizmi duke u angazhuar më tepër në superioritetin mbi meshkujt dhe duke harruar se qëllimi i kësaj lëvizje nuk është kënaqja e egos personale por është nevojshmëria për të qenë të barabartë me të tjerët. [13] Funksionet e këtyre lëvizjeve definohen si konstruksione teorike të cilat bazohen në vëzhgimin e sjelljeve dhe raportimeve të përjetimeve të vajzave dhe të grave deri në arritjen e konkluzionit se kush janë pesë arsyet se përse ky trend i përhapur në përmasa pandemike po afirmon një të ardhme me mungesë të dukshme të gjinisë femërore.

Së pari, arsyeja të cilës i atashohet e gjitha virulenca e përhapjes së problematikave e cilësuar ndryshe si hallka e parë e zinxhirit duke stimuluar rritjen e numrit të konformistëve, do të emërtohet si mosnjohja e saktë e konceptit të feminizmit. Në të shumtën e rasteve feminizmi është keqkuptuar dhe moskuptimi i drejtë i tij ka nxitur përshtatjen e kuptimit sipas mendësisë dhe interesave duke transformuar idenë fillestare në një ide kontraverse.[14] Shpesh individët i referohen më së shumti meshkujve me termin feminist, *"ç'djalë feminist",* por ky kuptim nuk i adekuohet asaj që fjala ka synim të tregojë, sepse të pëlqyerit një figurë femërore dhe të shkuarit pas saj me tendencën për ta pasur tënden si të ishte një objekt dhe jo një qenie frymore nuk të bën feminist, përkundrazi individët me dëshirë të vazhdueshme dhe të tepruar janë cilësuar "njerëz manjak".[15] Feminizëm nuk do të thotë që femra duhet të shihet si kult ndaj të cilës duhet të përulesh dhe ta

[13]Korth, E.. The Difference Between Today's Feminism Versus True Feminism. Aksesuar Tetor 10, 2021, nga https://www.perry-lake.org/ 0Feminism-Emily%20Korth.pdf.

[14] Piller, I. (2009). FEMINISM. In S. Chapman & C. Routledge (Eds.), *Key Ideas in Linguistics and the Philosophy of Language* (pp. 74–77). Edinburgh University Press. Aksesuar Tetor 13, 2021 nga http://www.jstor.org/stable/10.3366/j.ctt1g09vvm.30.

[15] kelly, janis. (1979). d.c. women drive out maniac. *Off Our Backs*, *9*(11), 14–14. Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/25793202.

nderosh çdo ditë, as që janë qenie të pagabueshme dhe të paprekshme pasi nisja e kësaj rryme nuk ka pasur për qëllim të kryesojë mbi të tjerët dhe të imponojë forma nderimi, por ka pasur tendencën që femrat të konsiderohen si njerëz me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta.[16] Fakti që lëvizja feministe ka kaluar përmes katër rrymave të cilat jo gjithkush i njeh por influencohet thjesht duke ndjekur shembullin e asaj që janë duke ndjekur të tjerët, ka shkaktuar çekuilibrim edhe në brendësi të vajzave dhe grave. Diversiteti i mendimit të lirë i nxitur së bashku me hapsirën e pranimit të idesë nga shoqëritë patriarkale ka shpërndarë fokusin nga qëllimi kryesor duke rezultuar që thelbi të humbasë kuptimin origjinal dhe të radikalizohet e të keqkuptohet.[17]

Kyç kryesor i emancipimit të femrës në shoqëri është përfshirja e saj në karrier që deri vonë prezumohej si një fushë që i përket vetëm meshkujve dhe në nevojë të kësaj janë identifikuar propozime për bursat e karrierës që kanë synim parësor mbështetjen e grave në zhvillimin e karrierës.[18] Kjo pavarsi e fituar ka ndikuar në shkëputjen e grave nga burrat dhe të mosnënshtrohen ndaj asnjë sjellje duke nxitur që ato të reagojnë ndaj situatave të cilat cënojnë dinjitetin e tyre. Vala e fundit e lëvizjes feministe ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në rritjen e numrit të divorceve për shkak të pavarsisë ekonomike që ato kanë arritur të fitojnë gjatë betejës së tyre për të qenë të pavarura.[19] Si rrjedhojë me një lidhje shkak-pasojë me të parën do të vendosen dy arsye të cilat ndërlidhen me mosnjohjen e konceptit dhe nga kuptimet e ndryshme që i atashohen termit të

[16] Kuçi, M..(2016). Feminizmi: Llojet dhe Keqkuptimet. *Sociologji.* Aksesuar Tetor 13, 2021 nga http://pendulumscimag.weebly.com/sociologji/feminizmi-llojet-dhe-keqkuptimet.
[17] Po aty.
[18] O'Neil, D. A., Hopkins, M. M., & Bilimoria, D. (2008). Women's Careers at the Start of the 21st Century: Patterns and Paradoxes. *Journal of Business Ethics*, *80*(4), 727–743.Aksesuar 27 Tetor, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/25482178.

[19]AMBERT, A.-M. (1985). The Effect of Divorce on Women's Attitude Toward Feminism. *Sociological Focus*, *18*(3), 265–272. Aksesuar 24 Tetor, 2021 nga http://www.jstor.org/stable/20831368.

feminizmit do të burojnë dy "fenomene" shumë të përhapur dhe të përfolur siç janë imoraliteti dhe shkatërrimi i familjes. Tendenca për të qenë të realizuara në ëndërrat e tyre duke dalë jashtë formës imponuese e cila duket sikur për vite me rradhë ka ndjekur trianglin martesë-fëmijë-familje ka dërguar në rritjen e numrit të grave që synojnë karrierën pa marrë parasysh se tërthorazi po dëmtohet institucioni i familjes pasi ende nuk është gjetur një metodë balancimi midis të dyjave. Kjo do të pasqyrohej në institutin e statistikave se në një total prej 7790 kërkesash për divorc, 4326 janë divorce me kërkesë të bashkëshortes, shifër kjo e cila demonstron se shoqëria ka arritur të largohet bindshëm nga prezumimi fetar dhe jo fetar se divorci është e drejtë ekskluzive e burrave.[20] Norma e martesës së grave sipas grupmoshës tregon se ka një rritje të moshës mesatare të vajzave (29 vjeç), por në tërësi për vitin 2020 rezulton një ulje e numrit të përgjithshëm të martesave krahasuar me vitet e mëparshme.[21] Lindshmëria ka pësuar një rritje të lehtë tek grupmoshat më të vjetra ndërsa abortet shënojnë numrin më të lartë me 21,1% të totalit tek gratë më nivel të lartë arsimimi dhe këtu do të merren parasysh vetëm abortet e provokuara që përveç arsyeve shëndetësore përfshin edhe konceptimin e fëmijës si pengesë për karrierën e tyre për shkak të obligimit familjar që imponon fëmija tek prindërit.[22] Kështu kemi një zhvendosje të idealizmit nga një familje e përsosur në një karrierë të përsosur pavarsisht kostos për të arritur qëllimin ku disa kontribuojnë në përmirësimin e vetes dhe disa bëjnë kompromis me moralin e tyre sepse praktika ka treguar që burrat e pasur ndryshe nga gratë që preferojnë të ngjashmin e tyre, ata kërkojne gratë e investuara në pamjen e jashtme duke i premtuar konkurimin me gratë të cilat kanë arritur të

[20] Vasmaghi, S. (2014). Divorce. In *Women, Jurisprudence, Islam* (1st ed., pp. 104–106). Harrassowitz Verlag. Aksesuar 30 Tetor, 2021 nga https://doi.org/10.2307/j.ctvc16s82.29.
[21] INSTAT (2021). Popullsia. *Gratë dhe Burrat në Shqipëri*. Aksesuar 27 Tetor, 2021 nga http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf.
[22] Po aty.

standartizojnë karrierën e tyre.[23]

Qasjet feministe kanë diapazone të ndryshme dhe kjo justifikohet me diversitetin e grave të cilat kanë larmishmëri të mendimeve, të kërkesave dhe të mënyrës së trajtuarit veten duke dërguar që disa prej tyre të fshihen pas viktimizimit në momentin që liria e tyre për të kërkuar apo për të poseduar një të drejtë thyen limitin e normales. Në këto kushte shoqëria përballet me dy lloje revoltash që i përkojnë revoltës së grave se sjellja e tyre nuk ka një limit kufizues dhe revoltës së burrave të cilët krejt natyrshëm e përkufizojnë sjelljen e grave si të udhëhequr nga egocentrizmi i tyre për të qenë të pavarura. Edukimi se gratë mund t'i kenë të gjitha dhe se janë të njëjta me burrat, hipoteza se burrat pëlqejnë më shumë gratë e suksesshme, opinioni se të jesh e pranueshme nuk mjafton nëse nuk je e shkëlqyeshme është duke e paralizuar shoqërinë në disa virtyte sipërfaqësore të cilat shpesh demonstrohen me anë të sjelljeve të pamenduara por riskuese.[24]

Vrasjet makabre të vajzave dhe grave në Shqipëri dhe përtej saj kanë gjithmonë në thelb një histori të vazhdueshme dhune dhe presionesh nga familjarët apo partnerët dhe vjen pikërisht pasi nis rebelimi i tyre për të kundërshtuar apo për t'u ndarë nga partnerët e tyre duke shënuar në vendin tonë deri në tetë vajza dhe gra të vrara për disa muaj të vitit 2021.[25] Kjo e dhënë statistikore mjafton për të kuptuar se pavarsisht se valët feministe po shtohen dita ditës dhe objektivat e tyre po ndryshojnë sipas kohës, fokusi ka ndryshuar koncentrimin duke kaluar nga mbrojtja e jetës në mbrojtjen e disa dëshirave abstrakte të ndryshme nga motivi i krijimit për të sjellë disa grupime

[23] Fotrell, Q.. (2016). Rich women like rich men, and rich men like slender women. Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga https://www.marketwatch.com/story/rich-women-like-rich-men-and-rich-men-like-slender-women-2015-09-28.
[24] Bohlin, S.. (2010). Ten lies of feminism. *Probe Ministires.* Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga https://bible.org/article/ten-lies-feminism.
[25] Lapsi.al. (2021). "Derisa vdekja të na ndajë"/ Vrasjet horror të grave dhe vajzave në muajt e fundit. Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga https://lapsi.al/2021/09/21/derisa-vdekja-te-na-ndaje-vrasjet-horror-te-grave-dhe-vajzave-ne-muajt-e-fundit/.

feministe që vendosin femrën në qendër dhe jo jetën e saj.[26]

Përmbajtja latente e lëvizjeve feministe po krijon një rend të ri i cili po çlirohet nga pengu i rrethit vicioz duke depërtuar jashtë kornizave të mentalitetit si e vetmja mënyrë për të dalur nga "errësira kolektive" që sipas tyre ka stopuar emancipimin e shoqërisë dhe pa e kuptuar po nxit revolucione të panevojshme për shkak se minimalisht ky aktivizim nuk po mundet të mbrojë jetën si një të drejtë themelore të çdo individi dhe jo më të garantojë të drejta që një pjesë e mirë e shoqërisë i dënon kategorikisht. Në 20 vitet e fundit në një vend të vogël si Shqipëria rregjistrohen 15 vrasje monstruoze pa llogaritur vrasjet e kryera nga shqiptarët në vendet e huaja, të vrara kryesisht për shkaqe xhelozie apo si pasojë e përndjekjes nga partnerët e tyre, sepse propaganda që ti mundesh të bësh gjithçka dhe askush nuk mund të të ndalojë po zhvillon makabritet pasi një shoqëri maskiliste si kjo e jona por edhe në disa vende të tjera të botës ende nuk janë të përgatitura që të pranojnë këtë fakt.[27] Paradoksi i feminizmit është se feministet e vërteta nuk e cilësojnë veten si të tilla dhe kur të gjithë flasin për barazi asnjë nuk mundet të definojë kuptimin e barazisë dhe as të përshkruaj se si duket ajo duke e kthyer në një fjalë me nënkuptues bosh.[28] Problematik e kësaj situate është energjia e humbur për të bindur burrat se termi femër është një term seksist dhe se në vend të saj duhet të përdoret emërtimi vajza dhe gra duke nëpërkëmbur faktin se sot ka një numër të konsiderueshëm vajzash dhe grash që do të pranonin të quheshin femër mjafton që të ishin ende gjallë.[29]

---

[26] Easton, M. (2012). FEMINISM. *Studies in Iconography*, *33*, 99–112. Aksesuar Nëntor 3, 2021 nga http://www.jstor.org/stable/23924276.

[27] Xing.al. (2018). 15 vrasjet monstruoze të grave në Shqipëri. Aksesuar Nëntor 2, 2021, nga https://www.tpz.al/2018/01/25/15-vrasjet-monstruose-te-grave-ne-shqiperi/#img=0.

[28] Madison, G., Aasa, U.. (2014). Feminist activist women are masculinized in terms of digit-ratio and social dominance.(5th ed ., pp. 10-11). Aksesuar Nëntor 2, 2021 nga https://doi.org/10.3389/fpsyg.2014.01011.

[29] Kraki, N.. (2020). Femër apo Grua? Aksesuar Nëntor 2, 2021, nga https://www.kultplus.com/opinione/femer-apo-grua/.

Albanian-American Development Foundation

Për të afirmuar rolin zhgënjyes të lëvizjeve feministe është realizuar një anketim me në qendër 84.8% femra dhe 15.2% meshkuj të moshave të ndryshme të cilët kanë shprehur mendimin e tyre sovran dhe duke treguar sesa informacion kanë për disa çështje të ndryshme. Ajo që vihet re është një lloj kundërshtimi i vetvetes që shfaqet më së shumti tek femrat të cilat besojnë se një femër mundet të jetë e pavarur por kjo femër nuk mund të jetë ajo vetë dhe kjo pasqyrohet se 92.6% mendojnë se femrat mundet t'ia dalin dhe 96.8% pohojnë se janë apo kanë njohur femra të forta, 5.3% kanë ende dyshime në forcën e tyre dhe 2.1% mendojnë që ato nuk munden t'ia dalin të vetme pasi janë qenie emotive dhe instikti i tyre nuk i lejon të jenë agresive në disa raste të ndryshme. Duket e logjikshme që individët besojnë më shumë tek forca e një femre sesa tek feminzmi dhe kjo pasqyrohet se 64.2% janë pro forcës së një femre dhe 16.8% janë pro feminizmit duke lënë një hapsirë prej 18.9% që të mbajnë një mendim asnjëanës pasi të dy konceptet i duken të njejta. Ajo që hap shumë debat është fakti se kur të anketuarit janë pyetur nëse ka patur një moment që kanë thënë "ah sikur të isha djalë" 21.1% kanë pohuar se jeta duket më e thjeshtë për ata dhe 12.6% kanë afirmuar së në vendin tonë e ardhmja është e frikshme për të qenë një femër e lumtur duke dërguar në një total prej 33.7% të vajzave dhe grave që kanë patur një moment të tillë në jetën e tyre dhe se 68.6% janë ndjerë të riskuara të paktën një herë vetëm sepse janë femra dhe si të palëkundur janë shfaqur vetëm 25.3% e të anketuarve. E bukura e këtij anketimi është se në përmbajtje të saj mbart një larmishmëri individësh nisur nga ata që e klasifikojnë veten në karrierë, ata që nuk janë në karrierë dhe ata që kanë gjetur një balancim midis obligimit familjar dhe atij profesional. Gati 92.8% ndajnë mendim pozitiv për gratë në karrier dhe ato besojnë se një grua mund të jetë 3B (Brain, Beauty, Booty) dhe 7.4% mendojnë se kjo është totalisht një ëndërr e cila vështirë se mund të realizohet, por kjo hidhet poshtë vetëm duke përmendur vajzat dhe gratë

afgane.[30] Shumë mendojnë se është besimi në vetvete dhe guximi ajo që i pengon, por do të veçoja njërin nga mendimet e të anketurave i cili pavarsisht se është një mashkull mendon që një vajze apo gruaje nuk i mungon asgje që të kthehet në një inspirim pasi kushdo duhet të kuptoj se logjika, vendosmëria për të arritur diçka dhe fuqia e të qenurit femër janë po aq femërore sa intuita dhe lidhja emocionale. Ai beson se kush nuk inpsirohet nga të paktën një femër ka pasur fatin më të keq të mos njoh Nënën. Nga mosbalancimi i mendimeve dhe mospërkrahja nga të tjerët 24.2% shkojnë për jetesën vetëm pasi hapsira është shumë e shenjtë për ta dhe kështu nuk do privoheshin për iniciativat e tyre dhe as nuk do rrezikonin të humbin jetën vetëm sepse nuk i nënshtrohen partnerit. 61.1% duan të jenë bashkpunues me partnerin apo partneren e tyre dhe vetëm 14.7% janë të mendimit se jeta e një femre duhet të përqëndrohet tek detyrimet shtëpiake. Paçka se tashmë nuk ka më dyshime se levizjet feministe janë një dështim të cilat nuk kanë arritur as minimalen e qëllimit për të cilin janë krijuar duhet mbajtur parasysh se një mashkull dhe një femër kurrsesi nuk janë të njëjtë dhe as të barabartë përveç përballjes së tyre me ligjin[31] dhe kushdo që ka dyshime në rolin dhe misionin e femrës në këtë botë duhet të ketë parasysh përgjigjen e një prej të anketuarve i cili shprehet se vajzat dhe gratë janë gjithë bota.[32]

[30] Ahmad, A. (2006). Afghan Women: The State of Legal Rights and Security. *Policy Perspectives*, *3*(1), 25–41. Aksesuar Nëntor 3, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/42909150.
[31] Hindelang, M. J. (1969). Equality under the Law. *The Journal of Criminal Law, Criminology, and Police Science*, *60*(3), 306–313. Aksesuar Nëntor 3, 2021, nga https://doi.org/10.2307/1141984.
[32] Be a man once. (2021). https://forms.gle/qWJjHmXzHieHLUEZA.

Bibliografia

1. Nezha, A. (2017). Familja, qeliza bazë e shoqërisë njerëzore. *Sot.al.* Aksesuar Shtator 25, 2021, nga https://sot.com.al/opinion-editorial.
2. SUGARMAN, S. D. (2008). What Is a "Family"? Conflicting Messages from Our Public Programs. *Family Law Quarterly*, *42*(2), fq 231–261. Aksesuar Shtator 25, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/25740655
3. Sheriati, A.. (2007). Krijimi i njeriut. *Njeriu dhe Islami.* Aksesuar Shtator 26, 2021, nga https://dielli.net/html/njeriuislam01.html.
4. Horowitz, M. C. (1976). Aristotle and Woman. *Journal of the History of Biology*, *9*(2), 183–213. Aksesuar Shtator 26, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/4330651.
5. Korda, N. (1996). Household Kates: Domesticating Commodities in The Taming of the Shrew. Shakespeare Quarterly, 47(2), 109–131. Aksesuar Shtator 26,2021, nga https://doi.org/10.2307/2871098.
6. Gjevoçi, Sh.. (1933). Libri i Tretë, Prindja. *Kanuni i Lek Dukagjinit.* Kreu VI, pika 59. Aksesuar Shtator 27, 2021, nga http://www.vatrarberesh.it/biblioteca/ebooks/kanuni.pdf.
7. Scott, J. W. (1989). French Feminists and the Rights of "Man": Olympe de Gouges's Declarations. *History Workshop*, *28*, 1–21. Aksesuar Shtator 29,2021, nga http://www.jstor.org/stable/4288921.
8. Skjelsbœk, I. (1997). [Review of *Women Reshaping Human Rights - -How Extraordinary Activists Are Changing the World*, by M. G. Bouvard]. *Journal of Peace Research*, *34*(1), 108–108. Aksesuar Shtator 29, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/424837.
9. Broom, D. (2020). As the UK publishes its first census of women killed by men, here's a global look at the problem. *World Economic Forum.* Aksesuar Tetor 6, 2021, nga https://www.weforum.org/agenda/2020/11/violence-against-women-femicide-census/.
10. Korth, E.. The Difference Between Today's Feminism Versus True Feminism. Aksesuar Tetor 10, 2021, nga https://www.perry-lake.org/ 0Feminism-Emily%20Korth.pdf.
11. Piller, I. (2009). FEMINISM. In S. Chapman & C. Routledge (Eds.), *Key Ideas in Linguistics and the Philosophy of Language* (pp. 74–77). Edinburgh University Press. Aksesuar Tetor 13, 2021 nga http://www.jstor.org/stable/10.3366/j.ctt1g09vvm.30.
12. kelly, janis. (1979). d.c. women drive out maniac. *Off Our Backs*, *9*(11), 14–14. Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/25793202.
13. Kuçi, M..(2016). Feminizmi: Llojet dhe Keqkuptimet. *Sociologji.* Aksesuar Tetor 13, 2021 nga http://pendulumscimag.weebly.com/sociologji/feminizmi-llojet-dhe-keqkuptimet.
14. O'Neil, D. A., Hopkins, M. M., & Bilimoria, D. (2008). Women's Careers at the Start of the 21st Century: Patterns and Paradoxes. *Journal of Business Ethics*, *80*(4), 727–743.Aksesuar 27 Tetor, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/25482178.
15. AMBERT, A.-M. (1985). The Effect of Divorce on Women's Attitude Toward Feminism. *Sociological Focus*, *18*(3), 265–272. Aksesuar 24 Tetor, 2021 nga http://www.jstor.org/stable/20831368

16. Vasmaghi, S. (2014). Divorce. In *Women, Jurisprudence, Islam* (1st ed., pp. 104–106). Harrassowitz Verlag. Aksesuar 30 Tetor, 2021 nga https://doi.org/10.2307/j.ctvc16s82.29.
17. INSTAT (2021). Popullsia. *Gratë dhe Burrat në Shqipëri*. Aksesuar 27 Tetor, 2021 nga http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf.
18. Fotrell, Q.. (2016). Rich women like rich men, and rich men like slender women. Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga https://www.marketwatch.com/story/rich-women-like-rich-men-and-rich-men-like-slender-women-2015-09-28.
19. Bohlin, S.. (2010). Ten lies of feminism. *Probe Ministires.* Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga https://bible.org/article/ten-lies-feminism.
20. Lapsi.al. (2021). "Derisa vdekja të na ndajë"/ Vrasjet horror të grave dhe vajzave në muajt e fundit. Aksesuar Nëntor 1, 2021, nga https://lapsi.al/2021/09/21/derisa-vdekja-te-na-ndaje-vrasjet-horror-te-grave-dhe-vajzave-ne-muajt-e-fundit/.
21. Xing.al. (2018). 15 vrasjet monstruoze të grave në Shqipëri. Aksesuar Nëntor 2, 2021, nga https://www.tpz.al/2018/01/25/15-vrasjet-monstruose-te-grave-ne-shqiperi/#img=0.
22. Madison, G., Aasa, U.. (2014). Feminist activist women are masculinized in terms of digit-ratio and social dominance.(5th ed ., pp. 10-11). Aksesuar Nëntor 2, 2021 nga https://doi.org/10.3389/fpsyg.2014.01011.
23. Kraki, N.. (2020). Femër apo Grua? Aksesuar Nëntor 2, 2021, nga https://www.kultplus.com/opinione/femer-apo-grua/.
24. Be a man once. (2021). https://forms.gle/qWJjHmXzHieHLUEZA
25. Ahmad, A. (2006). Afghan Women: The State of Legal Rights and Security. *Policy Perspectives*, *3*(1), 25–41. Aksesuar Nëntor 3, 2021, nga http://www.jstor.org/stable/42909150
26. Easton, M. (2012). FEMINISM. *Studies in Iconography*, *33*, 99–112. Aksesuar Nëntor 3, 2021 nga http://www.jstor.org/stable/23924276.
27. Hindelang, M. J. (1969). Equality under the Law. *The Journal of Criminal Law, Criminology, and Police Science*, *60*(3), 306–313. Aksesuar Nëntor 3, 2021, nga https://doi.org/10.2307/1141984.